KËRKESË
Nr. 108/4, datë 31.5.2021

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësim shpall kërkesën "Për shpronësim për interes publik të pronarëve të pasurive, pronë private, që preken nga projekti 'Rikualifikimi i sheshit të Kronit të Bogës"'.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Malësi e Madhe.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim për interes publik për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë".

Personat që preken nga ky projekt të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, në Bashkinë Malësi e Madhe, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësim.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 185,474 (njëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e katër) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM
TË SHPRONËSIMEVE
Erlis Hereni

LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE, PRONË PRIVATE, QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I PROJEKTIT "RIKUALIFIKIMI I SHESHIT TË KRONIT TË BOGËS"

Nr.	Emër Atësi Mbiemër	ZK	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. totale /m²	Sip. e shpronësuar/m²	Çmimi në lekë/m²	Vlera totale për shpronësim	Shënime
1	Shtet	1237	162/23	arë		84.39	208	0	Konfirmuar nga ASHK-ja
2	Shtet	1237	160/6	truall		80.45	231	0	Konfirmuar nga ASHK-ja
3	Shtet	1237	160/4	truall		18.25	231	0	Konfirmuar nga ASHK-ja
4	Shtet	1237	160/10	arë		25	208	0	Konfirmuar nga ASHK-ja
5	Shtet	1237	136/1	truall		72.5	231	0	Konfirmuar nga ASHK-ja
6	Shtet	1237	136/2	arë		52.8	208	0	Konfirmuar nga ASHK-ja
7	Zefjan Mark Ulaj	1237	160/5	arë		387.7	208	80,642	Konfirmuar nga ASHK-ja
8	Nikolin Tom Ulaj	1237	160/7	arë		504	208	104,832	Konfirmuar nga ASHK-ja
	Vlera totale					**1,225**		**185,474**	

Shënime.
1. Për tokën "arë", çmimi i llogaritur është marrë nga vendimi nr. 89, datë 3.2.2016, i Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë".